



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË**

Bashkia Lezhë, L.“Skënderbej”, Sh.“Gjergj Kastrioti”, 4501 Lezhë, Nr. Tel.00355 215 22270, e-mail: [f.frrokaj@lezha.gov.al](mailto:f.frrokaj@lezha.gov.al)

**P/ V E N D I M**

Nr \_\_\_\_\_, Datë \_\_\_ / 06 / 2016

**PËR**

**MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË LEZHË PËR VITIN 2016**

Në mbështetje të nenit 54, të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, të ligjit Nr.8399, datë 09.09.1998 “Për Buxhetin Lokal”, i ndryshuar; të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit Nr. 147/2015 “Për Buxhetin e vitit 2016”, të Udhëzimit M.Financave Nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, të Udhëzimit M.Financave Nr.1, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e Buxhetit për vitin 2016”, të Udhëzimit M.Financave Nr.4/1, datë 29.02.2016 “Për përgatitjen e Buxhetit Vendor”, të ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, të ligjit Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, të VKM Nr.1108, datë 30.12.2015 “Për transferimin nga MBZHRAU, te bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes e kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit”, dhe të VKM Nr.915, datë 11.11.2015 “Për transferimin në pronësi, nga këshillat e qarqeve, te bashkitë, të rrjetit të rrugëve rurale dhe të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të ndërmarrjeve të mirëmbajtjes së këtyre rrugëve”, Këshilli Bashkisë pasi shqyrtoj dhe analizoj projekt-propozimin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë;

**V E N D O S I :**

**I. Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Lezhë për vitin 2016, si më poshtë:**

**A. Të Ardhurat dhe Financimet gjithsej (1-7) 1.195.559.<sup>95</sup> mijë lekë**

Nga këto:

1.Të ardhurat tatimore dhe jotatimore	660450. <sup>00</sup> mijë lekë
2.Transferta e pakushtëzuar	230553. <sup>30</sup> “
3.Transferta e Kushtëzuar	9500. <sup>40</sup> “
4.Transferta Specifike	256840. <sup>69</sup> “
5.Të ardhura të trashëguara nga viti 2015	19290. <sup>36</sup> “
6.Grand i trashëguar nga viti 2015	15802. <sup>10</sup> “
7.Donacione	3123. <sup>10</sup> “

**B.** Shpenzimet gjithsej **1.195.559.<sup>95</sup>** mijë lekë, të detajuara sipas tabelave Nr.1, 1/1, 1/2, 1/3, 1/4 dhe tabelave Nr.3-21, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

**II.** Miratimin e Prioriteteve dhe Përdorimit të Fondit të Investimeve për vitin 2016 në shumën prej 205.401.<sup>1</sup> mijë lekë, nga këto; investime me fondet e bashkisë në shumën 145.778 mijë lekë; investime me fondet e buxhetit të shtetit 56.500 mijë lekë dhe investime nga donatorët 3123.<sup>1</sup> mijë lekë. Prioritetet dhe përdorimi i Fondit të Investimeve pasqyrohen në tabelat Nr.22-23, si pjesë përbërëse e këtij vendimi.

**III.** Miratimin e numrit të punonjësve të bashkisë, të njësive administrative dhe institucioneve të varësisë për vitin 2016, si më poshtë:

III/1.Numri i punonjësve gjithsej si bashki për vitin 2016 do të jetë 755 vetë, nga të këto :

- Punonjës të administratës së bashkisë 156 vetë, nga këto: 14 policë bashkiak.
- Punonjës të njësive administrative 148 vetë.
- Punonjës të institucioneve varëse 50 vetë.
- Punonjës të Agjensive 120 vetë.
- Punonjës me kontratë 6 mujore 50 punonjës (25 vetë vjetore).
- Punonjës që paguhen nga Transferta Specifike 243 (dyqind e dyzet e tre) vetë, nga këto: Konvikti 15 punonjës, Arsimi 167 punonjës, Q.K.Fëmijëve 5 punonjës, PMNZSH 30 punonjës, Ujitja e Kullimi 11 punonjës, Administrimi i Pyjeve 5 punonjës, dhe Rrugët Rurale 10 punonjës.
- Punonjës që paguhen nga Transferta e Kushtëzuar 13 (trembëdhjetë) vetë, nga këto; 11 punonjës të Gjendjeve Civile dhe 2 punonjës të Q.K.B.-it.

**IV.** Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

**V.** Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes dhe i shtrin efektet e tij për vitin 2016.

## **KRYETARI I KËSHILLIT**

**Gjok NDOKA**

Nr.\_\_\_\_Prot, Datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/2016

Kryetarit të Bashkisë Lezhë

Prefektit të Qarkut Lezhë

Arkivës së Bashkisë

## **SEKRETARJA E KËSHILLIT**

**Jerina VATAJ**